



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:055431

Datë: 06.12.2019

Numri i dokumentit: 00699211

DKR.P.nr. 103/2018

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE – Departamenti për krime të rënda në Pejë**, Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari, Sylë Lokaj, gjyqtaret, Sami Sharaxhiu dhe Sejdi Blakaj anëtar te trupit gjykues, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, *PP/I. nr.67/2018 te dt.04.12.2018*, të ndryshuar me dt.07.10.2019, kundër të akuzuarit S.B, për vepër penale te Grabitjes nga neni 329 par. 3 lidhur me par. 1 te KPK-së., pas mbajtjes së seancave gjyqësore me dt.23.05.2019, 07 dhe 08.10.2019 në prezencën e Prokurores së Shtetit, Sahide G, , të dëmtuarit G.G perf. për mbrojtjen e viktimave S. S , të akuzuarit S. B dhe mbrojtësit Av. Sali Mekaj, me dt. **10.10.2019** muar dhe publikisht shpalli:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**1.Skyfter B** i biri i A. dhe SH. e gjinisë I, i lindur me ... në Pejë me banim në Rr.”... Pejë, ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, me parë i pa gjykuar, ndodhet në paraburgim nga dt.26.06.2018 e në vazhdim.

**ËSHTË FAJTOR**

**-Për shkak se :**

Me dt.26.12.2017, rrethë orës 23, ne Rr. “ ...”, ne Pejë, me përdorim te forcës apo kanosjes serioze për te sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, me qellim qe ti sjelle vetes dhe personit tjetër dobi pasurore te kundërligjshme, se bashku me tre persona tjerë ende te pa identifikuar, kanë përvetësuar pasurin e luajtshme personit tjetër, ne atë mënyrë qe pasi që kanë shkua ne shtëpinë e te dëmtuarit G.G, e për mes qatisë kanë depërtua ne brendësi te shtëpisë, e kanë ndalë rrymën ne shtëpi, ne momentin kur i dëmtuari G. ka ardhë nga qyteti në shtëpinë e tij, e ka hap derën e shtëpisë dhe ka hyrë ne korridor, dy prej tyre i janë hedhur sipërmi duke thënë me fjalët “ Policia, policia” e shtrijnë për dysheme, me shirit ngjites ja lidhin gojën dhe këmbët, e tërheqin zhvarë deri ne dhomën e pritjes, ja vejnë prangat ne duar pas shpine, e ne kërkim te qelësave te kembimores “ ...”, pronë e te dëmtuarit qe gjendet ne qendër te qytetit për ballë pompës se Derivateve “ ... “, e godasin me mjete te forta ne kokë dhe shpind, për te detyruar te tregoj se ku i kishte fshehur qelësat e kembimores, me qerastë i shkaktojnë lëndime trupore, njeri prej te pandehurve me skalper ja prenë gjaketën te cilën e kishte te veshur i dëmtuari, ne gjepin e saj te brendshëm i gjejnë qelsat, te cilët i merrë njeri prej tyre dhe se paku dy prej tyre, pas mesnate rrethë orës 0:42,15 të dt.27.12.2016 shkojnë ne kembimoren ne fjalë, e hapin derën

me qelës , kanë hyrë brenda , e kanë qelë kasafortën dhe nga aty i marrin rrethë: 146.490,00 franga Zviceranë , 27.433,00 dollar amerikan , 52.090,00 euro, 1.237,23 euro ne valuta te ndryshme Norvegjeze , Suedeze etje, 262.95,00 lekë, si dhe një sasi ari në vlerë prej rrethë 15.000,00 euro, e pastaj përmes telefonit e njoftojnë njërin prej të pandehurve , qe e kishte ne mbajtje te dëmtuarin ne shtëpinë e ti, e pastaj largohen ne drejtim te pa njohur .

- me çka si bash kryes, ka krye vepër penale te grabitjes nga neni 329 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 te KPK-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 2, 3, 10, 31, 43 par.1 pika 1.2 dhe 1.3 , 45, 46, 50, 74, 83, lidhur me nenin 329 par.3 lidhur me par.1 te KPK-se, dhe nenit 365, 366, 367 par.1 pika. 1 .1 lidhur me par. 2, 450 par.1 dhe 2 pika 2.3, 2.6 dhe par.3 , 463 par.1 dhe 2 te KPPK-së, te akuzuarin e ;

## G J Y K O N Ë

-me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej gjashtë (6)vite

Në dënimin me burg, i llogaritët paraburgimi nga dt. 27.06.2018 e ne vazhdim .

-dënim gjobe ne te holla ne shumë prej tremijë (3.000,00) euro.

Dënimi me gjobë duhet te ekzekutohet ne afat prej 15 ditësh , e nëse i akuzuari nuk e ekzekuton apo e refuzon ekzekutimin e dënimit me gjobë , i njëjti dënim do te zëvendësohet me burg duke llogaritur 20 euro për çdo ditë burgu.

I akuzuari detyrohet qe gjykatës te ja paguaj :

-ne emër te shpenzimeve te procedurës penale shumen prej 200 euro, ndërsa ne emër te paushallit gjyqësorë shumen prej 40 euro.

-ne emër te kompensimit te viktimave te krimit shumën prej 50 euro.

I dëmtuari G. G nga Peja , për realizimin e kërkesës pronësore dhe dëmshpërblimin udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh , pasi qe aktgjykimi te mere formën e prere .

## A r s y e t i m

**1.Aktakuza:** Prokurori i shtetit në Prokurorin Themelore departamenti për krime të rënda në Pejë, ka ngritë aktakuzën , *PP/I. nr.67/2018 te dt.04.12.2018*, kundër të akuzuarit S. B, për vepër penale te Grabitjes nga neni 329 par. 3 lidhur me nenin 31 te KPK-së.

Përfaqësuesja e aktakuzë , Prokurorja e Shtetit Sahide G , në shqyrtim kryesorë, dt07.10.2019 e ka ndryshua kualifikimi ligjor të veprës penal, të akuzuarin e ka akuzua për vepër penale të grabitjes nga neni 329 par.3 lidhur me par. 1 të KPK-së. Dhe ka mbetë në tersi pranë aktakuzës , së ri-kualifikuaer te veprës penale.

I dëmtuari G. G i është bashkangjitë ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe ka parashtrua kërkesën për dëmshpërblim..

## **2.Provat e administruara ne shqyrtim kryesore:**

**2.1 Dëshmitaret e akuzës :** G.G, M.B , A.L , M.Q, ekspertet e forenzikes F.I dhe F. A.

**2.2 Provat formale të administruara ne shqyrtim kryesore::** Raporti informues i Policisë nr.2016 DA-2931-HRP-99,te dt.29.12.2016, dy raporte te policisë nr.16DA2961,t e dt.27.12.2016, Raporti i Spitalit te pergjithesh3em ne Pejë , për te dëmtuarin G.G me numër ... te dt.27.12.2016, dhe foto-dokumentacioni . Raporti i vendit te ngjarjes ne shtëpinë e te dëmtuarit nr., te dt.05.01.2017 dhe fotoalbumi , raporti i vendit te ngjarjes ne kembimoren G , ..., te dt.05.,01.2017, lista e dëshmime me nr.2016DA-2931, te dt.26 dhe 27.12.2016, dt.20, 21 dhe 22.03.2018. Raporti i te dhënave financiarë te dhen nga R... Banke ne emër te S. B te dt.16.08.2018, Raporti i marrjes se mostrave te ADN-së, dosja e forenzikes se KRP-së-16/1012, te dt.20 dhe 27.12.2016, raporti i ADN-së, AKF2017-..., te dt.04.09.2017.

Janë konstatuar si te lexuara dëshmitë : raporti i ekspertizës se ADN-së, nga forenzika me nr.AKF/.../2017-..., te dt.24.11.2017, raporti i ekspertizës se ADN-SË, me numër AKF/2017-..., te dt.13.09.2017, për eliminimin e gjurmëve papilare te të dëmtuarit dhe krahasimi i gjurmëve tjera te izolura nga personat te ndryshëm . Raporti i ADN-së, AKF/2018-0476/2018-467,t e dt.23.03.2018, krahasimi i gjurmëve papilare me personat te ndryshëm , raporti – i ADN-së, AKF/2017-0099/2017-88, te dt.04.09.2017, për krahasim te gjurmëve tjera te izolura , me gjurme papilare te personave te ndryshëm , raporti ekspertiza e ADN-së, AKF/2017-0099/2017-3770 te dt.19.09.2017, për eliminimin e gjurmëve papilare te të dëmtuarit dhe krahasimi me gjurme tjera te izolura nga personat e ndryshëm .

Është lexua Raporti – ekspertiza e ADN-së te bere nga Agjencia Kosovare për Forenzik me nr.AKF/2018-0476/2018-1302, e dt.25.05.2018, lidhur me përputhshmërinë ADN-se, për te pandehurin S. B me dy gjurmë te izoluar ne vende ngjarje . Është konstatuar si e shiquar CD e kamerës te siguruar ne kembimoren “ T...” te dt,27.12.2016, janë konstatuar si te lexuara dëshmia e S.B e dhen ne polici me dt.20.03.2018, dhe ajo e dhen te prokurori i shtetit me dt.31.07.2018, deklarata e te dëmtuarit G. G e dhen te prokurori me dt.30.07.2018.

## **3.Mbrojtja e te akuzuarit S. B :**

**3.1** I akuzuari, në procedurën paraprake në polici u deklarua me dt. 27.06.2018 ,te prokurori i shtetit me dt.31.07.2018 , në shqyrtim kryesorë me dt.17.07.2019 dhe me dt.07.10.2019.

Në shqyrtim kryesor tha: G. Gn, nuk e kam njohur. Më par nuk e kamë ditur se ekziston këmbimorja “T...” për ketë jam njoftuar vetëm kur jam arrestuar përkatësisht kur kam jap deklaratë në polici . Nuk e di se ku kam qenë me dt. 27.12.2016 , por për ketë më së miri e dinë policia që më kanë arrestua. Kur më kanë marrë në pyetje më kanë thënë se e kanë këqyrë telefonin tim përkatësisht lokacionin ku kam qenë unë atë ditë . Se ka ndodh grabitja në këmbimoren e quajtur T..., kam dëgjuar së pari nga thëniet e njerëzve dhe kam lexuar në portale .

Hetuesin e këtij rasti M. Q dhe punëtorë tjerë të krim teknikës, ndonjërin prej tyre e kam njohur më parë por nuk kam pas ndonjë raport me ta. Është e vërtetë se mostra e pështymës më është marrë nga ana e hetuesve me pëlqimin tim. Hetuesit nuk më kanë marrë mostrat e gjakut. Nuk kam pas ndonjë marrëdhënie pune e as që jam marr me ndonjë biznes të regjistruar në tri vitet e fundit. Kam qenë tregtarë i veturave por nuk e kam pas të regjistruar atë biznes. Është e vërtet se te Prokurori kam deklarua se kam ndejtë me personat A.I , A.M. , I.K, por unë nuk e kam ditur që ata persona kanë precedent penal. Në lokalit “K...” i cili gjendet përball shtëpisë së mallrave nuk kam ndejtë ndonjëherë dhe nuk e di se ku ndodhet saktësisht. Nuk e njoh dhe nuk e di se kush është N. G i quajtur “N.”. Të dëmtuarin G. Gn nuk e kam njohur më parë e as që

kam ditë se ai e ka këmbimoren “ T...” n ë Pejë. Para arrestimit, kam dëgjuar që është bërë një grabitje por nuk e kam ditur se kush ka qenë personi që është grabitë e as për këndë bëhet fjalë.

#### **4.-Fjala përfundimtare e Prokurorit;**

Prokurorja e shtetit Sahide G, Gjykatës fjalën përfundimtarë ja dorëzoi ne formë te shkruar dhe i është bashkëngjitur shkresave te lendes, për te shtua : edhe pas rihapjes së këtij shqyrtimi gjyqësor me arsyetim se kemi kundërthënë mes deklarimeve të ekspertëve të AKF-së dhe pse prokuroria ka konsideruar dhe vazhdon të vlerësoi se lidhur me çështjen kryesor për të cilën jemi këtu , ekspertët kanë mbete konsistent në konstatimet që i kanë bërë në raportin e ekspertizës së ADN-së, me nr. AKF 2018 -0476/2018-1302 të dt. 25.05.2018. Gjithashtu vlerësoi se ju dhe të gjithë ne jemi bindë se kemi të bëjmë me dy ekspert shumë të përgatitur me përvojë të cilët vijnë nga një Institucion më kredibilitet në Kosovë të cilët kanë përdorur instrumente dhe të gjitha pajisjet tjera nga Institucionet më kredibile në botë. Mbi të gjitha që asnjëri prej tyre e as të gjithë ata që janë involvuar në ekspertimin e këtij rasti nuk kanë njohur, e as nuk kanë pas ndonjë pretendim kundër të pandehurit S. B . Në anën tjetër me të gjitha provat është vërtetuar se në dy gjurmë të nxjerra nga vendi i ngjarjes, është gjetë ADN-ja e të akuzuarit S. , siç është njolla e kuqe e gjakut në jaknen e të dëmtuari G., e tjetra në kabllon me të cilën të dëmtuarit i janë lidhur duart, pas heqjes së prangave., e që nga raporti i ekspertizës se ADN-së, është vërtetua që i takojnë të akuzuarit , krahasuar një, në 32.5 bilion njerëz.

Sa i përket faktit se natën kritike kemi të bëjmë me një grup së paku prej tre personash përveç dëshmisë së të dëmtuarit G., këtë fakt e vërtetojnë të gjitha raportet e policisë për të gjeturat në vend ngjarje në shtëpinë e të dëmtuarit , pastaj video incizimet e kamerës së dyqanit të dëmtuarit. Prokuroria konsideron që dëmi që i është shkaktuar të dëmtuarit prej 146.490 Franga Zvicerane , 27.433.00 dollar Amerikan , 52,09.00 €, 1.237.23 € në valuta të ndryshme norvegjeze suedeze , 262.92.00 lek si dhe ari në vlerë prej 15.000 €, janë të vërtetuar në prova materiale por edhe me dëshminë e të dëmtuarit, e të cilat janë marr nga ky grup natën kritike. Andaj prokuroria mbetet në tërësi edhe më tej si në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim të dt. 18.07.2019, si dhe propozimeve të bëra në të.

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim të dt. 18.07.2019, Prokurori i Shtetit ka propozua që i akuzuari për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të detyrohet në kompensimin e shpenzimeve të procedurës , e në kuptim të nenit 96 dhe 97 të KPK-së të detyrohet që të dëmtuarit të ja kthej të hollat dhe sendet tjera të grabitura.

**4. 1.Qendrimi i palës se dëmtuar :** Përfaqësuesja për mbrojtjen e viktimave S. S në fjalën përfundimtare tha: në tërësi i bashkëngjitem fjalës së prokurores së shtetit .

I dëmtuari G. G në fjalën përfundimtare tha: në tërësi i bashkëngjitem fjalës përfundimtare të prokurores së shteti , i bashkëngjitem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, parashtroi kërkesën e dëm shpërblimit në lartësinë e dhën në formë të shkruar, ndërkaq e rezervoji të drejtën për kompensimin e dëmit tjetër material në kontest civil.

#### **4.-Fjala përfundimtare e mbrojtjes;**

Mbrojtësi i të pandehurit S., av. Sali Mekaj tha: fjalën përfundimtare e kam përgatitur në formë të shkruar dhe nga një kopje ia dorëzon kryetarit të trupit gjykues dhe prokurores. Mbrojtësi ne fjalën përfundimtarë me shkrim tha se sipas aktakuzës nder te tjera është konstatuar se “ ne marrëveshje paraprake te të akuzuarit dhe te grupit tjetër ku bëjnë pjesë se paku edhe tre persona tjerë ende te pa identifikuar . Këtë faktë nuk e ka pohuar asnjëherë i dëmtuari G. . Ai ne faktë ka thënë se ju kanë hedhur mbi shpine dy persona , pra nuk fletë as për tre as për katër persona . Ne shqyrtim kryesore nuk është provuar pretendimi i

prokurorit se i dëmtuari është sulmuar nga katër persona , edhe pse ky fakte është qenësor për vërtetimin e ekzistimit ose jo te elementit kualifikues se i akuzuari veproj si anëtar i grupit . Ndryshimi i dëshmisë se dëshmitarit përkitazi me këtë fakte vendimtar e bëjnë dëshminë ti te pa sigurte dhe te pa besueshëm për vërtetimin e ati fakti te rëndësishëm .

Ne aktakuzë sipas prokurorit te shtetit është konstatua “se ka pas marrëveshje paraprake “, edhe pse për ekzistimin e veprës penale për te cilën akuzohet i akuzuari nuk kërkohet ndonjë marrëveshje paraprake . Pretendimi i akuzës qe ekziston grupi prej katër personave qe ka veprua sipas marrëveshjes, paraqet një fakt qenësorë qe e bën veprën penale te trajtës se cilësuar e që faktet qenësore duhen te vërtetohen përtej çdo dyshimi te arsyeshëm, ne te kundërtën dyshimet për ekzistimin e fakteve ne dem te pandehurit sipas parimit i dubio pro reo , interpretohen ne favor te tij, e qe duhet te rrezohet pretendimi i aktakuzës . E sipas aktakuzës thuhet : “ ... e godasin me mjete te forta ne kokë dhe shpin për te detyruar qe te tregoj se ku i kishte fshehur te njëjtat , me çrastë i pandehuri S. me skalper, ja pren xhakëtën te cilën e kishte veshur i dëmtuari “. Ne shqyrtim kryesore me as një provë nuk është privua qe i pandehuri S. ja ka pre xhakëtën me skalper te dëmtuarit .

Nuk është kontestues fakti se vepra penale është kryer, e as provat me te cilat është vërtetuar ky faktë . Kontestues është fakti se ai ishte apo nuk ishte i akuzuari S. natën kritike me dt.27.12.2016, ne shtëpinë te dëmtuarit G.. I dëmtuari nuk e ka identifikuar te akuzuarin si kryes i mundshëm . Raportet e Kompanive telefonike te siguruara me dt.06.02.2016 dhe 01.05.2019, nuk dëshmojnë se ai ka qen ne vendin e ngjarjes apo ne periferi . As një raport i ekzaminimit te gjurmëve papilare te gjetura ne vendin e ngjarjes nuk provon pranimin e te akuzuarit ne vendin e ngjarjes , dëshmia CD e incizimit nga kamerat e sigurisë ne kembimoren ” T... “m te dt.27.12.2016, nuk e vërtetojnë pranin e te akuzuarit ne vendin e ngjarjes . Aktakuza mbështetet ne një provë te vetme raportin e ekspertimit te dt.25.05.2009 dhe deklaratat te eksperteve ne shqyrtim gjyqësorë. Nga raporti i hetuesisë rezulton se ne vendin e ngjarjes është gjetur një xhakete e shqyer , e cila është mare si provë evidentuar me shenjen EV # 9, kjo xhakete është paketua ne një qese te veçantë pasi qe është kontrolluar nga krim tekniku M. B , e ai ka thënë se nuk ka vërejtur diçka te veçantë qe do te thotë se nuk ka vërejtur njolla gjaku , këtë e kane pohuar edhe dëshmitaret A. L dhe M. Q .

Nga raporti i ekspertimit te dt.13.09.2017, ne përshkrimin e dëshmimeve te pranuar për ekspertim, nder te tjera thuhet se është pranuar një xhakete e shqyer me ngjyrë kafe , me numër EV # 9, me disa njolla te kuqe . Ky faktë e venë ne pikëpyetje dyshimin rreth pranisë se njollave te gjakut ne xhakete . Qeshja e dytë që e ve në dyshim serioz besueshmërinë e gjetjeve te konstatuara ne raportin e ekspertimit te ADN-së, është fakti se asnjeri nga ekspertet e dëgjuar ne shqyrtim gjyqësorë lidhur me procedurat dhe standardet e zbutura gjatë ekzaminimit te gjurmave biologjike te gjetura ne vendin e ngjarjes dhe te atyre te dërguara për krahasim , nuk ka dhen përgjigjeje ne pyetjet: se a kanë pasur certifikata te validimit te kemikateve te përdorura gjatë ekzaminimit , a kanë qen i certifikuar personeli i laboratorit dhe ekspertet , a kanë qen te përdorshme kitet identifikuese qe përdoren si referenca gjatë këtyre ekzaminimeve apo kanë qen me afat te skaduara, a kane qen te kalibruara dhe te certifikuara pas kalibrimit pajisjet laboratorike te përdorura ne këtë raste ekspertimi . Pra, u dëshmuua se ekspertet dhe personeli nuk janë te certifikuar për këtë lloj ekspertimi. Pa pasur dëshmi se kemikatet janë te certifikuar , pa u hequr dilema rrethë skadencës se afatit të kieteve identifikuese dhe pa certifikata te kalibrimit dhe servisimit te pajisjeve , nuk mundë te këtë përfundime te besueshme ne këtë fushë te ekspertimit .

Ne anën tjetër, fakti se kampionet e pështymës që janë marrë nga i akuzuari dhe personave tjerë, me qëllim të krahasimit me gjurmët biologjike që pretendohet që janë marrë nga vendi i ngjarjes, ato janë dërguar për ekspertim të shënuara me emër dhe mbiemër e jo të koduara, e kjo është në kundërshtim me standardin që kërkon ruajtjen e anonimitetit me qëllim të ruajtjes së objektivitetit të eksperteve .

Ekspertimi për veç se është marrë me shkelje të procedurave standarde është edhe i pa plotë, i pa qartë dhe ai nuk përmban të gjitha elementet ligjore që duhet të ketë një ekspertizë shkencore . Kjo mungesë e besueshmërisë të gjetjeve si në raport, u manifestua qartas me deklarin e eksperteve të dhenë në shqyrtim . Për deri sa eksperti L. I duke u përgjigjur në pyetje tha se një profil i një personi të njohur duhet të ketë 16 lokuesë të njëjta me profilet e ADN-së, të siguruar nga vendi i ngjarjes, e nëse e nuk përputhet vetëm një lokus, nuk mundë ta përfshin që është ai person . Ndërkaq eksperti F. A në seance ka deklaruar se pavarësisht që nuk përputhen 16 lokueset e mostrave krahasuese, ai person nuk mundë të përjashtohet nëse përputhen 15 të tjera . Pra, ka mos përputhje në mendimet e tyre. Në sqarimet e tyre ekspertet u përpoqën që lidhur me këto kundërthënie, se kjo varet nga sasia e ADN-së, e gjetur në vendin e ngjarjes, a paraqiten dy profile të plota apo të pjesëshme për krahasim, mjafton të jenë mbi 10 lokuesë . Në rastin konkret kemi një rast shkollorë të mos përputhjes së plotë të 16 lokuesëve të profilit të të akuzuarit me profilin e gjurmëve të vendit të ngjarjes, e ky është lokuesi i 16, i paraqitur në kolonën me shenjat “FAG”. Përpjekjet për të arsyetuar këtë mos përputhje me mungesë të sinjalit, “mungesë të mostrës së pastër, apo se “Mostra ishte mikstur”, jena argumente shkajshmërisë jo profesionale dhe vetëm sa kanë rritur shkallën e mos besueshmërisë në gjetjet e këtij ekspertimi .

Në qoftes të dhënat në konstatimet e eksperteve ndryshojnë thellësisht ose kur konstatimet e tyre janë të pa qarta dhe jo të plota dhe në kontraditë me vetë veten dhe me rrethanat e shqyrtuara, e në rast se këto të dhëna nuk mundë të mënjanojnë gjatë marrjes në pyetje të eksperteve, atëherë kjo provë nuk mundë të konsiderohet as kredibile e as e besueshme.

Të gjitha këto shkelje të procedurave dhe standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, e ulin kredibilitetin e kësaj prove, deri në nivel të provës së pa pranueshme e që si e tillë nuk mundë të shërbejë si provë në të cilën gjykata mundë ta bazojë aktgjykimin .

Në këtë qeshitje penale nuk është arritur të provohet në mënyrë të sigurt dhe me prova të qëndrueshme e të besueshme, se sa ishte shuma e parave që u morën në kembimorën e të dëmtuarit .

Të bazohesh në letra që i dëmtuari i nxjerre nga gjepi të ndryshuara dhe të përshkruar sipas dëshirës e që nuk kanë mbështetje në evidencat zyrtare të biznesit të tij, e që në shqyrtim nuk është marrë asnjë veprim për vërtetimin e faktit përfundimtar shumë e të hollave të grabitura, që do të ishte vendimtare për cilësimin juridik të veprës penale.

Bazuar nga të gjitha këto arsyeje që u prezantuan në argumentet përmbjllëse të mbrojtjes i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta liroj nga aktakuza komform neni 364 par.1 pika 1 .1 të KPPK-së.

Në rast se gjykata gjen se pretendimet e mbrojtës janë të pa qëndrueshme, mendoj se në asnjë rrethanë nuk behet fjalë për trajtat e cilësuar të veprës penale të grabitjes sikur që është përshkruar në dispozitën e neni 329 par.3, të KPK-së nga se nuk është vërtetuar ekzistimi i grupit në kuptim të kësaj dispozite ligjore. Prandaj në mungesë të provave për numrin e personave, rolet e tyre, aktivitetet dhe veprimet, pasi që ato që thuhet në aktakuzë janë vetëm supozime, mbrojtja konsideron se nuk mundë të behet fjalë për trajtë të cilësuar të kësaj vepre penale, por eventualisht për vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni .

I akuzuari S. B në fjalën përfundimtare deklaron se: në tërësi i bashkëngjitem fjalës përfundimtare nga mbrojtja, nuk kam se çka të shtoi tjetër.

## 5. Dëshmitë e dëshmitarëve :

**5.1. I dëmtuari G.G:** në cilësinë e dëshmitarit dha deklaratë ne Polici me dt. 27.12.2016, te prokurori i Shtetit me dt.30.07.2018 dhe në shqyrtimin kryesorë me dt.23.05.2019 .

Ai ne polici ka deklaruar se me dt.26.12.2016, pasi qe e kam mbyllë lokalin- kembimoren “ T...”, rrethë orës 23 , kam shkuar ne shtëpi e kam hapur derën e shtëpisë kam hy brenda , provokova ta ndez dritën , por nuk u ndez . Përderisa isha duke mbyll derën, dëgjova urdhëratë : “ Policia, mos lëviz “, mu kane hedhë për mbi shpin dy persona , më rrezuan për dysHEME , mi kanë lidhur duart me pranga , ma kanë mbyll gojën me një trak ngjitës , mi kanë lidhur këmbët . Pastaj më kanë tërhequr zhvarë deri ne dhomë, më vendosen për mbys dhe e kane mbuluar me një batanije .

Deri sa ka qen i shtrirë , njeri nga ata persona me thike apo diçka tjetër ja ka prere jaknen , ja kane hjekur pjesë, pjesë. E kane kontrolluar dhe i kane mare qel sat e dyqanit dhe te arkës te cilat kane qen ne gjemperin ngjyre te zeze ne gjepin e majte , gjate kohës sa ka qen i shtrirë e kane goditur me shkelma dhe me grushta ne trup . Pasi qe janë mare qelsat kamë dëgjuar se dikush ka dale jashtë shtëpisë . Rrethe orës 02, ka dëgjuar një bisede telefonike te cilën e ka bere njeri nga ata qe ishin aty gjate gjithë kohës ne mbikëqyrje te ti. Ai ne telefon ka thënë se a jeni gati . Pas një ore kame vrenjtur se as kush nuk ishte brenda ne dhome nuk ndihej as një fry marrje te personave tjerë , kam filluar te ngrihem ashtu i shqetësuar . Para se te dalin nga shtëpia me janë hequr prangat qe mi kishin vuar me herët ne dore dhe duart mi kane lidhe me një litar dhe një kabull te internetit , jam ngritur ne këmbë e kame arritur ti zgjidhi duart e kam hjekur tragën nga goja dhe ashtu duke kërcyer me këmbë te lidhura kame shuar deri te kuzhina e kame mare një thike dhe e kam prere traken ngjitëse qe e kisha ne këmbë . Pastaj kam dale nga shtëpia , kam shkuar te dyqani i vërejtja se dera ishte e mbyllur , mirëpo dryni nuk ishte i vendosur , dyshova se me është grabitur dyqani me qen se nuk kisha qelsa , kam shkuar ne pompën e derivateve “ P...” , dhe nga punëtori kërkova qe ta informoj policin , ata kane ardhë dhe se bashku me ta me forcë e kemi hapur derën e dyqanit , kemi vërejtur një rrëmujë arka ishte e hapur dhe aty mungonte e gjithë pasuria ime qe ishte rrethe 2.000,00 euro, ne bankënota te ndryshme , mungonte ari i motrës sime ne vlere rrethe 15.000 euro, ne kem bimorë i kame pasur nj epjes te të hollave te personave tjerë ne ruajtje nga unë 62.000 euro te personit I. SH , 19.000 euro te dhenderit tim E. K dhe 17.000 euro te vëllait tim B. Gt . Nga gjepi me janë mare 1.010 euro, ne apo ena te ndryshme .

Te prokurori i shtetit me dt.30.07.2018, ne tersi e ka shpjeguar ngjarjen sikur qe ishte deklaruar ne Polici , me ndryshim qe ai tha : “ kame dashtë ta ndeze dritën mirëpo nuk ka pasur sepse rrymën paraprakisht e kishin këputur , e këtë e kam vërejtur me vonë, ka deklaruar se “ Kur hyra brenda ishin katër persona dhe pasi qe kane bërtitur policia , policia me kane ra sipërmi , me kane shtrire për toke me fytyrë , mi kanë lidhe këmbët me ngjitës special , ma kane mbyllur gojën me ngjitës , ne duar mi kanë vendosur prangat pas shpendë , me kane ngre zhagë me kane futur ne dhomën e ditës , me kane vendosur ne pozitën për mbys , për mbi ma kane vendosur një qebe – jorgan , luftoja me fry marrjen isha i ngulfatur , me hipshin për sipërmi , dëgjoja hapat duke kërkuar neper dhome , ne një momente njeri prej tyre me ka hipur me gjunjë sipërmi dhe tjetri ka filluar me skajper te mi prej teshat- jaknen , deri sa i kane gjetur qelsat e dyqanit qe i kisha ne gjepin e jaknes . Supozoj se dikush prej tyre me ata qelsa ka shkuar ne dyqan, e kane hapur derën e dyqanit dhe sefin te cilat i kam pasur te mbyllura dhe mi kane mare 146.490.000, franga Zviceranë , 27.433,000 dollar Amerikan , 52.090,00 euro , valuta te ndryshme Norvegjeze , Suedeze e tjera, ne shume prej 1.237, 25 euro, një sasi te lekeve ne vlere prej 262,95 euro, ari ne vlere prej 15.000,00 euro, një ore dore .

Diku, pas një ore para se te përfundoj gjithçka kamë dëgjua njërin prej këtyre personave që ishte ne korridorin e shtëpisë duke biseduar me telefon me personat që kane qen ne dyqanin tim dhe i ka thënë “ A jeni gati “, pra ai nuk tha a je gati por ju tha a” A jeni gati “, dhe pas gjysme ore dikush ka ardhë , me ka hipur për sipërmi mi ka hekur prangat që ka pasur probleme gjate hapjes se tyre , nga se ishin shtrënguar aq shumë duart sa i kame pasur te përgjakura n yjet , e pastaj mi kane lidhur me një tel apo kabull e trashë , sa here që unë kam tentuar që ta ngris kokën duke luftuar me fry marrjen me kane goditur me një shofer metali që me vone e kame par që ka qen pjesë e fshises se metaltë , nga kjo edhe tani e tutje kam pengesa dhe pasoja . Pasi që pushuan goditjet dhe vërejtja se nuk ishte as kush aty , jam ngritur ne këmbë ashtu me vësh tersi i lidhur kame arritur te shkoj ne kuzhinë e kame mare një thikë fillimisht i kame liruuar duart , pastaj gojën nga ngjitësi dhe pastaj kame dale nga shtëpia .

Ne shqyrtim, kryesore dëshmitari e shpjegoj ngjarjen njëjtë si te Prokurori i Shtetit, me ndryshim se tani nder te tjerat tha se ..” ... ishin tre persona afër meje i katërtit pak anesh , këta persona mu gjuajtën ne qafë , mi kanë qitur duart prapa , mi kane qitur prangat , ma kane mbyllur gojën me ngjitës, dhe mi kanë lidhur këmbët “.

Lidhur me shumen e te hollave që i kishin mare dëshmitari tha se ne kohen kur kam dhen dëshmi ne Polici , shifrat i kamë dhen ne mënyrë te përafërm nga se kisha trauma , ndërsa te Prokurori i Shtetit i kam dhen te sakta . Ne polici kam deklaruar se te akuzuarin S. B me par nuk e kam njoftur dhe nuk me kujtohet se ka qen ndonjëherë ne dyqanin tim , ne dyqan kame pasur kamerat te sigurisë por personat që kane hyrë ne lokal kishin skyqur , personin që e dëgjova kur tha “ a jeni gati “, ai këtë e ka bere me gjysmë zëri . Personat , me vonë vërejtja se personat kishin hyrë ne shtëpi për mes te kulmit, qeset e kembimores –sefit i kam pasur ne gjepin e jaknes , ndërsa te dyerve i kam pasur ne gjepin e pantollave. Kam mbajtur evidence te kembimores që i kam mbajtur përkatësisht e që kam këmbyer gjate ditës dhe gjykatës ja dorëzoj bilancin ne dorëshkrim që e mban dt.26.12.2016, dhe bilancin e gjendjes nga dt.01.07.2016 deri me dt.30.09.2016, dhe pasqyra e te ardhurave e nga dt.01.07.2016 deri me 30.09.2017.

Evidencën ditore sikur që ajo që ja dhashë sot gjykatës, te dt.26.12.2016, e kam mbajtur përkatësisht gjendjen e arkës – shumen e te hollave që e kam ne posedim gjate ditës kam mbajtur evidence ne dorëshkrim që zakonisht e kam mbajtur ne gjep

Zërin që e dëgjova Policia , Policia ishte i njëjti zë kur foli me personat tjerë me telefon dhe kur tha “ A jeni gati “ , por ne baze te zërit nuk mundë ta di se kush ka qen ai person .

**5.2. Dëshmitari M. B** ka dhen dëshmi me dt.23.05.2019 a tha se :punoj ne drejtorin rajonale te policisë njësia e forenzika.

Ai tha:Ne rastin konkret kam shkuar ne vendin e ngjarjes . kemi konstatua se pika depërtuese ne shtëpinë e viktimës ka qen nga kulmi i shtëpisë ku edhe është gjetur një dorëz e ngjarës se kaltër e varur që sipas konstatimit ton, dorëza aty i ka mbet nga personat e dyshuar, gjatë depërtimit përmes kulmit.

Dera e shtëpisë se viktimës e ka hyrjen nga rruga kryesore, poqa elektrike që ishte ne hyrje brenda ne korridor ka qen e thyer, e janë vërejtur gjurmët e thyerjes ,ne një pjes te dhomës kam gjetur ngjitës, copa litari, kablllo te këputur. Aty është gjetur një xhaketë e shqyer ,një skalper, e ne dhomë ka pasur rrëmujë.



Është bere fotografimi i vendit të ngjarjes skicimi ,identifikimi i dëshmime me numra identifikues . Dëshmitë i kemi mbledhur se cilen veç e veç i kemi vendosur ne qese për ruajtjen e tyre deri ne eksportim.

Dëshmia –gjaketa qe është gjetur ne shtëpinë viktimës është evidentua si dëshmi #9 është futur ne qese si e terë , ajo ka qen e prerë me mjetë prerës. Objektet qe mirën si dëshmi ato paketohen , nuk kamë vërejtur diçka te veçantë ne gjaket. Hapja e dëshmime përkatësisht për hapjen e tyre para ekzaminimit, është procedurë e veçantë, por unë e nuk kam marr pjesë kur është hapë.

Dëshmia #11, ka qen një kablo e ngjyrës se bardh , ka qenë e lidhur nyje ne një vend dhe e këputur ne një vend tjetër .

Pastaj kemi vazhdua ne vendshiqim ne kembimoren “T... “qe ndodhet ne qendër te Pejës. Dera është gjetur e hapur ,përkatësisht qelsi gjysmë i mbyllur (por jo i mbyllur )nuk ka pas gjurmë se ajo është hapur me forcë .

Ne lokal kemi vërejtur një ulëse qe ishte përdor për te hupur dhe për ta çmontuar kamerën ,kamera ka qen e kthyer nga tavani ,ne karrik ka qen një gjurmë e kamerës. Mbi banak kemi gjetur një dry te hapur i ndamë ne dy pjesë.

Para banakut ka pasur rrëmujë ,arka ka qen e hapur ajo i kishte 3 dryna dhe qe te tre te hapur ,ndërkaq kapakët e brendshëm ishin te hapur me mjet te fort qe kishin mbet gjurmët mirëpo mjeti nuk është gjetur ne vend te arka kemi gjetur një gjurmë qe ndërlidhet me modelin e dorzes qe është gjetur ne kulmin e shtëpisë se viktimës dhe at enje thurje e dorezave qe është e ngjashme me dorezën qe edhe qetur ne kulmi e shtëpisë se viktimës. kabllot e kamerave kishin qen te shkuqura e qe pas shikimit te kamerave , shihet se është ndërpre incizimi ne momentin kur personi ka hyr brenda. Nuk kemi mundur te gjejmë dëshmi – gjurma papilare apo te ngjashme .

Kur është shikua kamera e kembimores, vërehet se personi qe ka hyrë brenda , e ka kapur kamerën, e kthen përpjetë , e sipas incizimit personi është i maskuar.

**5.3. Dëshmitari A. L** ka dhen dëshmi ne shqyrtimin e dt.23.0-5.2019. Ai tha se si anëtar i ekipit hetues te forenzikes kam marr pjesë ne vende -ngjarjen kritike.

Dëshmia #9, është gjetur ne dyshemenë e dhomës , ajo ka qen e shqyer , e prere. Dëshmia është evidentuar dhe është futur ne qese te veçantë , është mbyllur me shirit. Pas ngjarjes kam pas kërkesë nga hetuesi M. Q përkatësisht me ka njoftuar se jam caktuar ne një komision për heqjen e dëshmisë numër #9 . Kam marr pjesë si anëtar i komisionit. Ishim unë , S. L., hetuesi M. Q dhe zyrtari i dhomës se dëshmime M. M. dhe është bere procesverbali . Arsyeya për hapjen e dëshmisë ka qen qe nga gjepi i jaknes te hiqen disa sende që i ka kërkuar i dëmtuari, e qe kan qen ne gjepin e sajë. Pas hapjes se dëshmisë ne prezencën komisionit është mbyllur me shirit dhe është berë procesverbali .

**5.4. Dëshmitari M. Q** ka dhen dëshmi me dt.17.06.2019.dhe me dt.07.10.2019.

Ai tha se: punoi në policin më e Kosovës regjionale të hetimeve në Pejë në sektorin e grabitjes që nga viti 2007 . Ky rast ka ndodhur me dt. 26.12.2017 të mbrëmjes, e unë kam shkuar në vendshikim të nesërmen. Rasti ka ndodh në dy vende, njëri ka qenë në shtëpinë e viktimës dhe tjetra në lokalin e viktimës që në vij ajrore është diku rreth 1 km . në fakt un kam shkua në vendin e ngjarjes së pari në lokalin ku ndodhet në rr. .... Ditën kritike kam marr udhër nga mbikqyrtësi që unë të hetoi kamerat nëpër qytet në vendin ku është dyshuar apo që kanë mundur të kalojnë personat e dyshimt. Në fillim nuk kemi pasur person të dyshuar. Në për zbulimin rastit kemi procedua disa dëshmitar dhe me punë operative kemi marrë informacion për personat të mundshme për zbulimin e kryerjes së kësaj vepre.

Nga dëshmitë që janë marrë në vendin e ngjarjes ato janë dërguar në laboratorin e forzikës aty janë gjetur profilet për krahasime e pastaj pasi që janë analizua, ne kemi filluar një hetim për gjetjen e personave të mundshme që ju përputhen mostrës së dëshmive. Në fillim kemi shkua në eliminimin e personave duke krahasua me të dhënat nga laboratorin e forenzikës . Në bazë të dyshimeve të personave, i kemi ftua si dëshmitar në fillim, e me pëlqimin e tyre nga ata i kemi marrë mostrat për krahasim. Veprimet për marrjen e mostrave i ka kryer njësitë e Forenzikës që janë të certifikuar për to. Deri me tani i kemi marr 27 profile- mostra nga personat e ndryshëm që e kemi dërguar në ekzaminim e ndër personat që ne i kemi marrë mostrat ka qenë edhe tani i akuzuar S. B që ja kemi marrë me dt. 20.03.2018 ndërsa e kemi dërguar për ekzaminim me dt. 29.03.2018. e rezultatin e ekzaminimit e kam pranuar me dt. 20.05.2018.

Për hapjen e dëshmisë #9 kanë qenë dy arsye, së pari kërkesa e viktimës për ti marrë disa gjëra personale të tij, një kartel bankare, një sasi të hollave dhe disa fatura bankare. Dhe arsyeja e dytë ka qenë që me shikua mundësin se si është nxjerr jakna nga trupi i viktimës kur ai ka qenë i lidhur me të dy duart prapa shpinës. Kjo hapje është bërë në bazë të rregullave procedurale të përcaktuara me rregulloren e ZDPO -02 /008 /14 dt. 15.05.2014 dhe është bërë raportit mbi hapjen e dëshmisë #9 të rasatit 2016 – DA -2931 të dt. 04.01.2017 . Nuk kemi vërejtur se në jakne të ket pasur gjurmë gjaku. Edhe pse nuk kam vërejt ndonjë shenjë gjurmë të veçantë në jaknën e viktimës, e arsyeja pse është dashtë që ajo të dërgohet për ekzaminim në laboratorin e forenzikës , është se ne si hetues, çdo dëshmi që e sigurojmë më vendin e ngjarjes, për rastet e pa zbuluar, zakonisht i dërgojmë për ekzaminim e kjo është procedurë standarde .

Të akuzuarin më parë nuk e kam njohur dhe nuk kam pas ndonjë herë ndonjë konflikt unë apo familja ime me të e as nuk kam dijen nga kolegët e mi të ketë pas ndonjë konflikt me të akuzuarin. Ndërsa që, të dëmtuarin para këtij rasti, ka kohë që e njoh e di që ai ka punuar me deviza. Nuk kam pas ndonjë raport të afërt me të .

Ne jemi në veprim të hetimit për zbulimin e personave tjerë të mundshëm të këtij rasti e kjo mbi bazën e faktit se nga mostrat e siguruar përveç profilit tani të akuzuarit, janë gjetur edhe dy profile tjera të personave ende të pa zbuluar.

## **6. Vlerësimi i provave formale:**

Janë vlerësua raporti informues i Policisë nr.2016 DA-2931-HRP-99,te dt.29.12.2016, dy raporte te policisë nr.16DA2961,t e dt.27.12.2016, Raporti i vendit te ngjarjes ne shtëpinë e te dëmtuarit nr.16/12, te dt.05.01.2017 dhe fotoalbumi , raporti i vendit te ngjarjes ne kembimoren G , nr.A-001, te dt.05.,01.2017, lista e dëshmive me nr.2016DA-2931, te dt.26 dhe 27.12.2016.

Nga këto dëshmi është provua se ngjarja ka fillua me dt. 26.12.2016 rreth orës 23,00 në shtëpinë e të dëmtuarit , dhe ka vazhdua pas orës 24 të asaj nate në lokalit këmbimoren e viktimës me dt. 27.12.2016 deri rreth orës 0:42,15. e kjo argumentohet edhe nga CD e kamerave të sigurisë .

Është vlerësua dëshmia CD incizimi i kamerës së sigurisë që është marrë në këmbimoren “te gazi”. Në këtë incizim vërehet qartë, kur një person i maskuar, hynë në këmbimore me dt. 27.12.2017 pikërisht në ora 0.42 min. e 15 sek.

Nga kjo dëshmi , bazuar në faktin e vërtetuar nga ekspertiza e forenzikës, më poshtë të arsyetuar , si në pikën 8 të arsyetimit , me besueshmëri të fortë mund të nxirret konkluzioni se i akuzuari S. nga fillimi e deri në fund ishte në shtëpinë e viktimës e që nuk ishte fare në këmbimore, por që aty ishte apo ishin, personat tjerë tani të pa identifikua , të cilët pasi që i

morën qelsat nga viktimat, ai apo ata, shkuan në këmbimore dhe i kryen veprimet –i morën të hollat dhe sendet tjera të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nuk ishte kontestuar fakti se i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore natën kritike e kjo argumentohet edhe nga Raporti i Spitalit të pergjithshëm në Pejë me numër ... të dt.27.12.2016, dhe foto-dokumentacioni .

Është vlerësuar raporti i të dhënave financiare të dhën nga “R...” në emër të S. B të dt.16.08.2018, nga i cili vërtetohet se i akuzuari para dhe pas kryerjes së veprës penale, nuk ka pasë ndonjë qarkullim të madhe financiar.

## **7. Vlerësimi i dëshmitëve të dëshmitarëve:**

**7.1.** Gjykata e ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit G.G, ai ishte dëshmitar i ndershëm dhe i besueshëm e që gjykata, ja ka falë besimin për faktet e pa kontestueshme e të argumentuara edhe me dëshmi të tjera e ai ka vertetua:

-se ai është pronar i këmbimores “T...” në Pejë ,e përderisa ai në orët e pasdites, me dt. 26.12.2016, e ka mbyllë lokalin- këmbimoren “ T...”, rreth orës 23 , ka shkuar në shtëpi e ka hap derën e shtëpisë ka hy brenda ,ka provua ta ndez dritën por nuk i është ndez .

- se, përderisa ishte duke mbyll derën, në errësirë ka dëgjua urdhëratë : “ Policia, mos lëviz , tre persona ju kanë gjuajtur në trup ndërsa i katërti person ka qëndruar te dera, e kanë rrezuar për dysheme ,ja kanë lidhur duart me pranga , ja kanë mbyll gojën me një trak ngjites , ja kanë lidh këmbët, e kanë tërhequr zhvarë deri në dhomë. Deri sa ka qen i shtrirë , njeri nga ata me thike apo diçka tjetër ja ka prerë jaknen , i kanë marrë qelsat e dyqanit dhe te arkës, ka dëgjuar se dikush ka dalë jashtë shtëpisë . Pas rreth dy orëve ka dëgjuar një bisede telefonike të cilën e ka bërë njeri nga ata që ishte në mbikëqyrje, e ai në telefon bashkëbiseduesit i ka thënë **“a jeni gati “**.

-se pas një ore, me që ja kishin heq prangat nga duart, e ja kishin lidhë me një trakë ,e kur nuk ka dëgjua zë e asnjë frym- marrje të personave , ka filluar të ngrihet dhe ashtu i shqetësuar i ka heq lidhëset dhe ka dalë nga shtëpia.

Gjykata ja falë besimin të dëmtuarit, se ai në errësirë, në baz të veprimeve ka mundur të kuptoi se janë së paku katër persona.

Është për të besuar se dëshmitari- viktimat, derisa ai ishte i shtrirë, nuk pati mundësi ta vërej se cili prej tyre ja preu jaknen . Ai ishte i sinqert dhe i besueshëm kur tha ”njeri nga ata me thike apo diçka tjetër ma ka prerë jaknen”

Ai ishte i besueshëm kur tha se përderisa ishte i prangosur , i lidhur, në errësirë e i mbuluar me qebe, dëgjoji njërin prej tyre që tha “a jeni gati”.

Nga kjo, gjykata ka formuar bindjen e fortë, se gjatë kohës sa mbahej nën kontroll i dëmtuari , aty ishte së paku një person, i cili personave që i morën qelësat e këmbimores dhe shkuan atje, ju tha në telefon duke u shpreh në shumës “a jeni gati”. Nga këto, vërtetohet se në veprimet e kësaj veprë, kanë marrë pjesë së paku katër persona.

Është vlerësuar dëshmia e të dëmtuarit lidhur me shumën e të hollave dhe sendeve me vlerë-arit , që i ka pasë në ruajtje në këmbimore, e që Gjykata pjesërisht ja ka falë besimin.

Ai në fazën fillestare tha se në këmbimore natën kritike ka pas rreth 200.000,00 euro, ne bankënota te ndryshme dhe ari ne vlere rrethe 15.000 euro.

Te prokurori i shtetit tha se i ka pas 146.490.000, franga Zviceranë , 27.433,000 dollar Amerikan, 52.090,00 euro , në valuta te ndryshme Norvegjeze , Suedeze e tjera, llogarit në ero ne shumë prej 1.237, 25 euro, një sasi te lekeve ne vlere prej 262,95 euro, ari ne vlere prej 15.000,00 euro, një ore dore .

Në shqyrtim kryesorë, tha se ne kohen kur kam dhen dëshmi ne Polici , shifrat i kamë dhen ne mënyrë te përafërm nga se kisha trauma , ndërsa te Prokurori i Shtetit i kam dhen te sakta, e që Gjykatë ja dha si dëshmi në dorëshkrim.

Gjykata ja ka falë besimin të dëmtuarit , ti ketë pas shumat e përafërta të te hollave dhe të sendeve të deklaruara gojarisht dhe të konstatuara në një fletë në dorëshkrimin e tijë, e që ato të i janë marrë natën kritike në këmbimoren e tije. Andaj, Gjykata shumat e të hollave dhe sendet e grabitura natën kritike, i konsideron të vërtetuara si të përafërta e me sigurinë më të madhe , që tejkalojnë shumën prej mbi 5.000,00 ero.

**7.2** Gjykata e ka vlerësua dëshmitë dëshmitarëve, **M. B , A. L** dhe **M. Q** për secilin veç e veç , ata ishin të ndershëm dhe të besueshëm, e që gjykata ua falë besimi për faktet e pa kontestueshme dhe ato të argumentuara nga dëshmitë tjera. Edhe pse ata nuk ishin dëshmitar okular të ngjarjes, sidoqoftë ata vërtetuan faktet në vijim:

Dëshmitaret **M. B** dhe **A. L**, argumentuan faktet e pa kontestueshme, se pika depërtuese ne shtëpinë e viktimës ka qen nga kulmi i shtëpisë ku edhe është gjetur një dorëz e ngjarës se kaltër e varur qe sipas konstatimit , dorëza aty i ka mbet nga personat e dyshuar, gjatë depërtimit përmes kulmit.

Dera e shtëpisë se viktimës e ka hyrjen nga rruga kryesore, poqa elektrike qe ishte ne hyrje brenda ne korridor ka qen e thyer. Pra aty ka qenë errësirë.

Në shtëpinë e viktimës janë identifikua dëshmitë që janë konsiderua të nevojshme për ndriçimin e rastit e ato konform ligjit janë evidentua në listë të dëshmime, skicua dhe fotografua e pastaj sipas procedurës janë paketua dhe janë marrë për hetim.

Pastaj është vazhdua ne vend shikim ne kembimoren “T... “që ndodhet ne qendër te Pejës janë identifikua dëshmitë që janë konsiderua të nevojshme për ndriçimin e rastit e ato konform ligjit janë evidentua në listë të dëshmime, skicua dhe fotografua e pastaj sipas procedurës janë paketua dhe janë marrë për hetim.

Ata argumentuan faktin e pakontestueshëm se ,kamera në këmbimore ka qen e kthyer nga tavani , kabllot e kamerave kishin qen te shkyçura e qe pas shikimit te kamerave , shihet se është ndërpre incizimi ne momentin kur personi ka hyr brenda e sipas incizimit personi është i maskuar.. Aty përveç tjerave është gjetë një gjurmë qe ndërlidhet me modelin e dorëzës qe është gjetur ne kulmin e shtëpisë se viktimës.

Nga kjo dëshmi- gjurma qe ndërlidhet me modelin e dorëzës qe është gjetur ne kulmin e shtëpisë se viktimës, argumentohet fakti i pohuar nga viktima se dikush nga personat që e lidhen në shtëpi, ka dalë nga shtëpia , e më vonë personi që ishte në mbajtje të tij ka komunikua me telefon.

Ata argumentojnë faktin e pakontestueshëm se para banakut ka pasur rrëmuje ,arka ka qen e hapur ajo i kishte 3 dryna dhe qe te tre te hapur ,ndërkaq kapakët e brendshëm ishin te hapur me mjet te fort .

**7.3.** Dëshmitaret A. L dhe M. Q , argumentojnë faktin se është hap dëshmia Ev #9, e që gjykata ua falë besimin, se arsyeja për hapjen e dëshmisë ka qenë vetëm për hetim, e asësesi për ndonjë qëllim tjetër, e që kjo hapje është bërë në bazë të rregullave procedurale të përcaktuara me rregulloren e ZDPO -02 /008 /14 dt. 15.05.2014 dhe është bërë raportit mbi hapjen dhe mbylljen , nr. rasatit 2016 – DA -2931 të dt. 04.01.2017 .

Ata pohojnë se nuk kanë vërejtur që në jakne të ketë pasur gjurmë gjaku, por nuk e përjashtojnë mundësinë që aty të ketë pas gjurma- njolla të kuqe, e që pikërisht për këte edhe është marrë si dëshmi për ekspertim.

Gjykata i ka pranua si të ligjshme, sqarimet e këtyre dëshmitarëve, që ata si teknik të forenzikës, para mbylljes së dëshmive në paketim , e bëjnë përshkrimin e të gjeturave, por edhe pse nuk e kanë konstatua se në gjaketë ka pas njollë të kuqe, ata nuk e përjashtojnë mundësin që ato të kenë qenë të padukshme, e që në forenzikë janë identifikua.

## **8. Analiza- Vlerësimi i dëshmive formale-Ekspertizave të forenzikës:**

**8.1.** Sipas listës se dëshmive, vërtetohet se ne shtëpinë e te dëmtuarit janë marr edhe dëshmitë te evidentuar nga dëshmia # 1 deri ne dëshminë # 16, ndërkaq ne kembimoren e te dëmtuarit janë marr dëshmitë nga dëshmia # 17 deri ne dëshminë # 22. Ne raport është konstatuar se sipas nevojës për hetim , dëshmitë e evidentuara # 1 , #2, #3, #5, #6, mundë ti nen shtrohen ekzaminimit dhe analizës se ADN-së, e me pas ekzaminimit daktiloskopik , ndërkaq dëshmitë me numër #9, #10, #11, #12, # 14, #15, dhe #16, mund ti nënshtrohen vetëm ekzaminimit për analizë te ADN-së, ndërkaq dëshmia #22, munde ti nënshtrohet ekzaminimit për përputhje fizike . Ne raport është përshkruar puna e teknikes kriminalistike ( veprimet e ndërmarra hetimore dhe atë : fotografimi , tërheqja e gjurmëve te mbathurave me gjurme kopjuese, nxjerrja e përmasave dhe skicimi , mbledhja dhe paketimi i dëshmive . Së fundmi gjykata ka ardhë në përfundim se te gjitha veprimet tekniko hetimore janë kryer ne ekip nga tekniket A. L , M. B , ashtu sikur kërkohet me ligje

**8.2.** Nga raporti i ekspertimit AKF 2017-0099/2017-88, te **dt.04.09.2017**, e qe kanë qenë ne ekzaminim Daktilografik dëshmitë nga lista e dëshmive, 1, 2, 3, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 15 dhe D#1 G.G , ku pas procesimit nuk janë nxjerre – zhvilluar as një gjurm e vijave papilare , ndërkaq ne dëshmia # 14 nuk është procesua nga se sipërfaqja e dëshmisë ka qen e pa përshtatshme , nuk ka hapësirë te mjaftueshme për nxjerrjen e vijave papilare, ndërkaq dëshmia #16 nuk është procesu nga se sipërfaqja e dëshmive ka qen e pa mjaftueshme për procesim .

Në fakt, sipas kësaj dëshmie nuk ka mund të provohet prania e gjurmëve papilare të akuzuarit , në dëshmitë e murrura në vendngjarje.

**8.3.** Nga raporti i ekspertimit AKF/2017-0099/2017-87, te **dt.13.09.2017**, e qe kanë qen për ekzaminim dëshmitë EV#1- EV#2, EV#3, EV#5, EV#6, EV#9 EV#10, EV#11, EV#12, EV#14 EV#15, EV#16, dhe EV#G/G, me detyrë qe nga këto dëshmi te nxjerrën mostrat e ADN-së, te krahasohen ne mes veti dhe ne bazë te dhënave te ADN-së . Ashtu qe është dhen konstatimi dhe mendimi përfundimtarë se nga dëshmia EV#G/G, është fituar profili i ADN-se së G. Gt , pastaj nga dëshmitë EV#3, EV#5, EV#6, EV#14, dhe mostrat EV#9.1 dhe EV#9.2, te marrura nga dëshmia EV#9 (gjaketa e te dëmtuarit ), është përfituar një profil i njëjtë i ADN-së , i cili profil

përputhet me profilin e ADN-se se G. Gt , e qe gjasat e paraqitjes se këtij profili ne populacion është 1 ne 44.8 bilion individ. Nga mostra EV#9.3, e marrur nga dëshmia EV#9 ( gjaketa e te dëmtuarit ), është fituar një profil i përzier i ADN-së, nga se paku dy persona . G. G nuk munde te përjashtohet si njeri kontribuues i ADN-së ne këtë përzierje .

Nga dëshmia EV#15 dhe EV#11, është fituar profili i përzier i ADN-së , nga se paku nga dy persona te pa njohur .

Nga dëshmia AV#12, nuk është fituar profil i ADN-së, për shkak te sasisë te pa mjaftueshme te ADN-së.

Gjithashtu nga dëshmia EV#1 dhe EV#2 dhe EV#16, nuk është fituar sasi e mjaftueshme e ADN-së,

Ndërsa ne dëshminë EV#10 , nuk është identifikuar ADN-ja me origjinë njerëzore.

**8.3.a.**Nga kjo dëshmi është provua se në dëshminë EV#9 (gjaketa e viktimës) është fituar një profil i përzier i ADN-së, nga se paku dy persona e G. G nuk mundë te përjashtohet si njeri kontribuues i ADN-së ne këtë përzierje .

**8.3.b.**Gjithashtu është provua se në dëshminë EV.#11( një pjesë e lidhëses plastike ngjyrë e bardhë) dhe në dëshminë EV.# 15 (pako e pallomave) është fituar profili i përzier i ADN-së , nga se paku nga dy persona te pa njohur .

**8.4.** Nga raporti i ekspertimit AKF2017-0099/2017-3048,t e dt.**24.11.2017**, qe ka qenë objekt i ekzaminimit te dëshmime #AG #MM #AB #DK #EOL #EG #AT #IS ,( mostrat standarde te pështymës te marrur nga 8 personave te dyshimë ), dhe nga këto dëshmi te nxirret profili i ADN-së , ne mënyrë qe te krahasohen ne bazën e te dhënave qe i ka poseduar Agjensioni i Kosovës për Forenzik. Dhe është dhen konstatimi përfundimtar se profilet e ADN-së, te fituara nga ata persona , nuk përputhen me profilet e ADN-së, ne bazën e te dhënave te ADN-së, dhe me profilet e fituar nga raporti i ekspertizës AKF/2017-0099,t e dt.13.09.2017.

**8.5.**Nga raporti i ekspertimit AKF/2017-0099/2017-3770, **dt.19.01.2018**, e qe objekte ekzaminimi ka qen dëshmitë #DZD, #B.M, #GJ.M ( mostër e pështymës te marruara nga tre persona t e dyshuar ), e qe është dhen konstatimi dhe mendimi përfundimtar se profilet e fituar nuk janë përputhur me ndonjë profil te ADN-së , ne bazë te të dhënave te ADN-së , si dhe me profilet e fituar nga raporti i ekspertizës me numër AKF 2017-0099/2017-87 dt.13.09.2017.

**8.6.**Nga raporti i ekspertimit AKF2018-0476/2018-467, te **dt.23.02.2018**, e qe kanë qen objekte ekzaminimi i dëshmime #SH.L, #ADN1, #ADN2, #ADN3, dhe ADN4 ( mostra standarde te pështymës te marrur nga pesë persona te dyshuar ). Është dhen konstatimi dhe mendimi përfundimtarë qe profilet e ADN-së te fituara nuk përputhen me profilet e ADN-së , te fituara nga raporti i ekspertizës AKF/2017-0099/2017-87, te dt.13.09.2017.

**8.7.**Gjykata vlerëson se ekspertizat AKF2017-0099/2017-3048, dt.24.11.2017, AKF/2017-0099/2017-3770,dt.19.01.2018,AKF2018-0476/2018-467 dt.23.02.2018, kanë të bëjmë me hetim për persona tjerë më parë dhe tani të dyshuar si kontribuues të ADN-së , e me qe ato nuk kanë të bëjmë me tani të akuzuarin, si të tilla i konsideron si krahasuese , por jo vendimtare në raport me të akuzuarin S..

**8.8. Është vlerësua raporti –ekspertiza e bere nga Agjensia e Kosovës për Forenzikë , AKF/2018-0476/2018-1302, te dt.25.05.2018**, e qe objekt i ekzaminimit kanë qenë:

Dëshmitë #ADN5, mostër standarde e pështymës e marrur nga A. I.

Dëshmia #ADN6, mostër standarde e pështymës e marrur nga S. B .

Dëshmia #ADN7, mostër standarde pështymë e marrur nga As. M dhe  
Dëshmia ADN8 , mostër standarde pështymë e marrur nga I. K .

**Është dhen konstatimi dhe mendimi përfundimtar se :**

Nga dëshmitë # ADN5, #ADN6, #AQDN7 dhe #ADN8, janë fituar profilet e ADN-së se A. I ,  
S. B , A. M dhe I. K .

Është konstatua se S. B ( #ADN6), nuk mundë te përjashtohet si kontribuues i dytë i ADN-së,  
ne mostrën Ev#9.3, e marrur nga dëshmia Ev#9 ( një gjaket me ngjyrë kafeje , e shqyer , e  
marrur nga G.G, me disa njolla te kuqe-gjak ). **Gjasat e paraqitjes se këtij profili , ne  
populacion, është 1 në 32.5 bilion njerëz.**

Profili i pjesshëm dhe i përzier i ADN-së. I fituar nga dëshmia Ev#11 ( një pjesë e lidhëse plastike  
, ngjyrë e bardhë ), **ka indikacione te profilit te S. B (#ADN6).**

Ndërkaq, profilet e fituar nga personat A.I , As. M dhe I. K , nuk përputhen me profilet e fituar  
nga raporti i AKF/2017-0099/2017-87 dhe me te dhënat tjera qe i ka poseduar Agjensioni .

Profili i ADN-së , i fituar nga S. B ( ADN6-së) nuk përputhët me te dhënat tjera qe i posedon  
Agjensioni .

**8.8.a.** Nga kjo ekspertizë shkencor, e që gjykata ja ka falë besimin , është vërtetua se në jaknen  
e të dëmtuarit G.G, e cila është marrë në shtëpinë e tij dhe është evidentua si dëshmia Ev.#9,  
kanë mbetë gjurma të gjakut, e që pas analizimit të profilit të ADN-së, është vërtetua se S.B ( #ADN6),  
nuk mundë te përjashtohet si kontribuues i dytë i ADN-së .

Gjithashtu në dëshminë Ev#11 një pjesë e lidhëse plastike , ngjyrë e bardhë, është fitua profil i  
pjesshëm dhe i përzier i ADN-së, që ka indikacione te profilit te ADN-së së S.B , e që gjasat e  
paraqitjes se këtij profili , ne populacion, janë, 1 (një) në 32.5 bilion njerëz .

**8.9.** Konstatimin dhe mendimin përfundimtar sipas këtij raporti te ekzaminimit, ne shqyrtim  
kryesorë, bindshëm e kanë mbrojtur dhe argumentuar, eksperti i parë i rastit L.I dhe eksperti i  
dytë verifikues F.A , e qe gjykata ne tersi ja u ka falë besimin .

**8.9.a.** Eksperti i forenzikes **L. I** , në shqyrtim kryesor 23.05.2019 të plotësuar me dt.17.10.2019,  
e ka arsyetua konstatimin e tij shkencor të dhen me shkrim në raportin- ekspertizën AKF/2018-  
0476/2018-1302 dt. 25.05.2018.

Ai tha se është specialist i lart i forenzikes , me profesion master i shkencave te biologjisë , me  
detyrë ne laboratorin e ADN-së si ekspert i mostrave biologjike përkatësisht për analizën e  
ADN-së, ka ndjekur trajnime për analiza biologjike , analizat e ADN-së, trajnime tjera shtesë ,  
nga ekspertet Ndërkombëtar dhe vendorë qe nga viti 2010.

Ai tha se Laboratori i Forenzikes punon me aparatura ma moderne ne rajon . Kemikalet me te  
cilat punohet analiza e ADN-së, prodhohen nga dy tri kompani ne nivel Botëror , e te cilat i  
furnizojnë te gjitha laboratorët e nivelit botëror . E kamë punua ekspertizën lëndore me numër  
AKF 2018-0476/2018-1302 te dt.25.05.2018.

Ne këtë rastë kanë ardhë katër mostra standarde nga katër persona te njohur , qe te nxirret profili  
i ADN-së dhe te krahasohen me raportet me numër AKF/0099/2017-3084 dt.24.12.2017, qe me

par i kishim punuar. Nga ky krahasim kemi nxjerre konkluzionin si ne vijim : Nga dëshmia # ADN 5, #ADN 6, #ADN7 dhe # ADN 8, janë përfituar profilet e ADN-së, se A. It , S. B , As. Mt dhe I. K .

Me këtë është konstatuar se personi me numër 2, S.B , dëshmia ADN # 6, nuk mundte te përjashtohet si kontribuues i dytë i ADN-së, ne mostrën EV#9.3, e marrur nga dëshmia EV9, një gjaket me ngjyre te kafes e shqyer e marrur nga G.G me disa njolla te kuqe-gjakë.

Gjasa e paraqitur e këtij profili, ne populacione 0, me popullin njerëzor, është një (1), në 32.5 bilion njerëz .

Konkluzioni me numër 3 i rastit konkret -2018-0476 thotë se : profili i pesëfishim dhe i përzier me ADN-se i fituar nga dëshmia EV11, një pjesë e lidhëses plastike ngjyrë e bardhë , ka indikacione te profilit te S. B .

Ky konkluzion lidhet me konkluzionin numër 5 te rastit 2017-0099, sepse atje kemi konstatuar se nga dëshmia EV11, është fituar një profil i përsëritshëm dhe i përzier i ADN-së , nga se paku nga dy persona , e ky profil ka indikacione te profilit te S. B .

Konkluzioni nr.4 profilet e ADN-se ,te fatura nga A.I , As. M dhe I.K , nuk përputhen me profilet e fatura nga raporti nr.2017-0099 e as me te dhënat tjera qe posedon agjensioni . Konkluzioni qe i referohen njollave te kuqe, behet fjalë për dëshminë EV#9, konkretisht xhaketen me ngjyrë kafe me njolla te kuqe. Kjo gjaket ka qen e shqyer dhe e njollosur me njolla gjaku , ne pjesën e sipërm te kapela dhe ne pjesën ku është marr mostra EV# 9.3.

Mostra EV#9.3, është marr me tampon pambuku edhe ne sipërfaqen ku ka pasur njoll gjaku por edhe ne sipërfaqen me te gjerë te xhaketes , andaj ka dal si përzierje – mikstur (shprehja) . Eksperti ka shpjeguar se ne rastet kur nxjerrët një profil i pastër i ADN-së, nga një vendë i ngjarjes , pastaj sjellët mostra e njohur ose referente e marrur nga personi i caktuar – i njohur , nxirret profili i ADN-së dhe krahasohet me profilin e ADN-së te fituar nga vendi i ngjarjes . Pastaj kur nuk përputhët , themi se ky profil nuk përputhët me profilin e vendit te ngjarjes dhe ky person përjashtohet . Ndërsa kur kemi përputhje te ADN-së , themi profili i ADN-së, i fituar nga personi XX përputhet me profilin e ADN-se e fituar nga dëshmia XX, kështu qe ky person nuk mundë te përjashtohet si kontribuues i ADN-së ne këtë dëshmi , qe do te thotë sikur qe thashë ne variantin e parë, përputhet, e ky nuk mundë te përjashtohet . Ky ishte sqarim për terminologjinë dhe për statistika , sepse edhe kur përputhët nuk i themi se ky person është ky . Kjo sepse analizohen 16 vende ne kuadër te molekules se ADN-së dhe nuk analizohet e terë ADN-ja e njeriut ( gjithë kjo është sqarim për terminologjinë përdorur ne konkluzionin 2 dhe 3 ). Pasi qe nuk analizohet e tere ADN-ja por vetëm ne 16 vende ipet statistika se sa është gjasa me qen një person i dyte me profile te njëjtë ne rruzullin tokësorë . Dhe ne baze te statistikës del se e tere kolona për dhjetëra qindra apo mija here, ne popullsinë botërore , gjegjësisht e numrin e popullsisë botërorë . Qka nënkupton se ai profil është unik dhe për shkak te etikes profesionale nuk mund te themi termin ( Ky person është ky ), sepse nuk analizohet e tere ADN-ja.

Ekspertizën formale e kamë punua si ekspert kryesor, por ne bazë te rregullores, çdo mendim i ekspertit kryesorë verifikohet edhe nga një ekspert i dytë ne kuadër te laboratorit qe ka shkollim ekuivalentë apo me te lartë , e ne rastin konkret, e ka bere eksperti F.A .



Laboratori ku unë punoj për çdo vit i nënshtrohet testit, por dhe unë si ekspert i ADN-së, i nënshtrohem testit të aftësive profesionale për çdo vit, e kur e kalon e merr autorizimin për vitin vijues .

Kemikatet që përdoren në laborator çdo here janë të validura , por në përsëri para përdorimit në një rast të caktuar e bëjmë testin . Njollat e kuqe, në dëshminë Ev#9 në gjaket ka qenë njollë e dukshme , mostrat biologjike duhet të mirën dhe të ruhen në pakon e letrës . Dëshmia EV#9, ka qenë e marrur dhe e ruajtur sipas standardeve.

**8.9.b.**Eksperti i forenzikës **F.A** ka dhënë dëshmi në shqyrtimi të dt.01.07.2019 të plotësuar me dt.17.10.2019, ai tha se është me profesion biolog ekspert i ADN-së në Agjencionin Kosovari për Forenzikë në Prishtinë ,shef i laboratorit të ADN-së, ai tha se forenzika posedon aparaturë të sofistikuar, ka procedurat e punës të kualifikuara dhe të pranuar.

Në ekspertizën lëndore të dt,25.05.2018 unë kam qenë si ekspert i dytë verifikues. Sipas rregullave të brendshme është krijuar mekanizmi i rishikimit të konstatimeve të ekspertit të parë nga një ekspert i dytë i cili duhet të jetë i një nivel si me ekspertin e parë ose më i lart . Eksperti i dytë kontrollon komplet punën e ekspertit të parë në aspektin teknik, sipas procedurave të aprovuara të punës dhe verifikon se a janë përdorur aparaturat e duhura për analizë dhe mjetet tjera të punës , se a janë konkluzionet në harmoni me rezultatet, pastaj kontrollohet saktësia e ekspertit të parë, e nëse vërehet ndonjë lëshim në procedurë, eksperti i dytë e kthen rastin të ekspertit të parë për plotësim.

Ekspertiza e ADN-së janë shumë të sakta e që vlerësohen me statistika konkrete . Nuk ka shansë që dy persona të kenë profilin e njëjtit të ADN-së, me përjashtim të rasteve kur personat janë bineq që në të themi Monozogol.

**8.9.c.**Në shqyrtimin të dt.17.10.2019, ekspertet e forenzikës F.A dhe L. I kanë deklaruar se qëndrojmë në tersi pranë ekspertimit – mendimit përfundimtarë sipas raportit të ekspertimit AKF 2018-0476/2018-1302, të dt.25.05.2018.

Për çështjet e ngritura nga mbrojtja, se për mungesë të një lokusi, nga 16 si në rastin konkret, përkatësisht për mos përputhshmërinë e një lokusi , a ka ndikim në rezultat. Ata ishin unik dhe kanë konstatuar se në rastë se themi se një lokus ka ra prej vlerës së sinjalit të dobët , atëherë është standard, mos përputhja e ti me lokuset tjerë . Nëse në 15 lokuse të fituara krahasohen me 15 lokuse të siguruara nga personi , atëherë statistikën janë për ato 15 lokuse , e atëherë ruhet korrektesia e statistikës, sepse ipet për lokuset që janë përputhur . E nëse dikush e konteston rezultatit, në rastin prej 15 lokuseve , ai mundë të krahasohet në statistika që del në biliona apo biliarda persona . Në fundë të fundit edhe me 10 lokuse nëse përputhen , është i besueshëm në përkrahjen e statistikës , ndërsa nëse ato janë në dhjetë lokuse të përputhshme , rezultatet nuk mundë të pranohen me përjashtim nëse gjykata e provon me dëshmitë tjera eventuale përkatësisht me provat rrethore . Ky është një standard që përdoret në shumë shtete të rajonit . Në rastin konkret në punë për ekspertim kanë qenë për mbi 30 profile të personave të ndryshme dhe janë nxjerrë profile të ADN-së, nga të gjithë këta persona , duke përfshirë edhe të akuzuarin S. B . Te gjitha këto profile janë krahasuar me mostrat e gjetura në vendin e ngjarjes dhe të gjithë personat tjerë janë përjashtuar si kontribuues të ADN-se, me përjashtim të S. B .

Kemikatet të cilat i posedojmë dhe i përdorim dhe ato të rastit konkret janë ble në kompanitë prestigjioze ku shumica e laboratorëve të Evropës dhe të Botes furnizohen nga ato kompani . Ato kemikate edhe pse janë të besueshme dhe të festuara , është rregull që ato të testohen edhe njëherë në laborator para se të përdoren e kështu është vepruar edhe në rastin konkret.

Mostra e ADN-së , e gjetur ne gjaketen e te dëmtuarit –gjak , ka qen mostër e mjaftueshme qe i ka plotësuar kushtet për një ekzaminim laboratorik .

**8.9.d.** Gjykata i ka vlerësua konstatimet përfundimtare te ekspertëve, të cilëve ja u ka falë besimin, e ata vërtetuan:

- se Laboratori i Forenzikes punon me aparatura ma moderne ne rajon, e ato kanë qenë të kalibruara .

-se pajisjet dhe ata vetë kanë qenë dhe janë të certifikuar.

-se kemikatet me te cilat është punua analiza e ADN-së, prodhohen nga dy tri kompani ne nivel Botëror , e te cilat i furnizojnë te gjitha laboratorët e nivelit botëror.

-se ato me rastin e përdorimit kanë qen të testuara më parë, por edhe para përdorimit janë testua.

**-se S. B ( #ADN6), nuk mundë te përjashtohet si kontribuues i dytë i ADN-së, ne mostrën Ev#9.3, e marrur nga dëshmia Ev#9 ( një gjaket me ngjyrë kafeje , e shqyer , e marrur nga G.G, me disa njolla te kuqe-gjak ). Gjasat e paraqitjes se këtij profili (profilit të te akuzuarit), ne populacion, është 1 (një) , në 32.5 bilion njerëz.**

- se Profili i pjesshëm dhe i përzier i ADN-së. I fituar nga dëshmia Ev#11 ( një pjesë e lidhëse plastike , ngjyrë e bardhë ), **ka indikacione te profilit te S.B (#ADN6).**

(ekspertët sqaruan se përdorimin e termit “nuk mundë te përjashtohet si kontribuues” . Ata thanë se edhe kur përputhën të gjitha lokuset, nuk i themi se ky person është ky . Qka nënkupton se ai profil është unik. Për shkak te etikes profesionale nuk mund te themi, ky person është ky, por thuhet “nuk mundë te përjashtohet si kontribuues” ) sepse nuk analizohet e terë ADN-ja).

## **9.Vlerësimi i mbrojtjes se te akuzuarit .**

**9.1.**Gjykata e ka vlerësua mbrojtjen e të akuzuarit S. dhe ka formua bindjen e fortë se mbrojtja e të akuzuarit, është në kundërshtim të thellë me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, e të arsyetuara si në pikat: 5 deri në 6 të arsyetimit të këtij aktgjykimi, e pa argumentuar me as një provë bindëse, vetëm me një mohim krejtësisht të pa bazuar, e orientuar vetëm ne shmangien nga përgjegjësia penale.

I akuzuari gjatë terë kohës ka mohua veprimet për të cilat akuzohet. Ai tha se të dëmtuarin G. Gn, nuk e ka njohur më parë, nuk e dinë ku e ka shtëpinë e as këmbimoren e quajtur “ T...” në Pejë.

Gjykata vlerëson si të besueshëm fakti se i akuzuari , nuk e ka njohtë të dëmtuarin, por pretendimi se nuk e dinë ku ndodhet këmbimorja “T...” pastaj se nuk e dinë se ku ndodhet lokali “K...”, e në anën tjetër e pohon , se kur ka ndodh grabitja në këmbimoren e quajtur “...”, ka dëgjua, së pari nga thëniet e njerëzve e pastaj nga portalet . Kjo mënyrë e mbrojtjes, se ai nuk e din ku ndodhen këmbimorja dhe lokali , për fatin se ato ndodhen në qendër të qytetit, e i akuzuari është banues në Pejë, e blejnë pa besueshme mbrojtjen e të akuzuarit.

**9.2.** Janë vlerësua qëndrimet e mbrojtësit të te akuzuarit Av. Sali Mekaj të ngritura në shqyrtim kryesorë.

Gjykata pajtohet me qëndrimin e mbrojtësit, që nuk është kontestues fakti që vepra penale e grabitjes është krye e që provat e vërtetojnë këtë faktë.

Sipas mbrojtësit, kontestuese janë faktet:

- se a ishte apo nuk ishte i akuzuari natën kritike në shtëpinë e të dëmtuarit e që i dëmtuari nuk e ka identifikuar të akuzuarin si kryes i mundshëm.
- ligjshmëria e sigurimit të dëshmimeve Ev#9 dhe Ev#11.
- mjetet jo valide, përkatësisht validiteti i laboratorit dhe kemikateve e përdorura gjatë e ekspertimit të dëshmimeve Ev#9 dhe Ev#11.
- pastaj se nuk ka ekzistuar grupi prej katër personave, që kanë vepruar sipas marrëveshjes, dhe së fundmi shumica e të hollave të grabitura, e që këto fakte janë qenësore, që e bëjnë veprën penale të trajtës së cilësuar por që nuk është provuar, e që sipas mbrojtjes, dyshimet për ekzistimin e fakteve, sipas parimit in dubio pro reo, duhet interpretuar në favor të të pandehurit.

Gjykata e pranon qëndrimin e mbrojtjes se i dëmtuari nuk ka mundur ta identifikoi të akuzuarin e as personat tjerë që ishin natën kritike në shtëpinë e tijë.

Kjo për faktin e vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit-të dëmtuarit G.G, i cili ishte shumë i ndershëm dhe i besueshëm e që Gjykata ja ka falë besimin, e ai vërteton që personat i kanë hye në shtëpi përmes kulmit, e kanë thye poqën elektrike e në errësirë të plotë ja kanë vënë prangat në duar, ja kanë lidhë këmbët, ja kanë mbyllë me ngjithës gojën, e që ata kur i kryen veprimet, e kanë ashtu, vetëm që ja hoqën prangat ja lidhen me një lidhëse duartë dhe u larguan. Në fakt, ai nuk pati mundësi të shikonte figurat e personave që i kishin hye në shtëpi, por i identifikoi që ishin katër persona.

Se a ishte apo nuk ishte i akuzuari natën kritike në shtëpinë e të dëmtuarit, bindshëm është vërtetuar në ekspertizë AKF/2018-0476/2018-1302, dt.25.05.2018, e që Gjykata ja ka falë besimin.

Sipas kësaj ekspertize është vërtetuar se S.B (#ADN6), nuk mundë të përjashtohet si kontribuues i dytë i ADN-së, në mostrën Ev#9.3, e marrur nga dëshmia Ev#9 (një gjaket me ngjyrë kafeje, e shqyer, me disa njolla të kuqe-gjak që është marrë në shtëpinë e viktimës).

Gjithashtu sipas kësaj ekspertize është vërtetuar se, profili i pjesshëm dhe i përzier i ADN-së. I fituar nga dëshmia Ev#11 (një pjesë e lidhëse plastike, ngjyrë e bardhë, që është marrë në shtëpinë e viktimës) ka indikacione të profilit të S.B (#ADN6).

**Nga këto konstatime është vërtetuar se gjasat e paraqitjes së profilit nga dëshmia Ev#9, në popullacion, është 1 (një) në 32.5 bilion njerëz.**

Konstatimin dhe mendimin përfundimtar sipas këtij raporti të ekzaminimit, në shqyrtim kryesorë, bindshëm e kanë mbrojtur dhe argumentuar, eksperti i parë i rastit L.I dhe eksperti i dytë verifikues F.A, të konstatuar si në pikën 7. të arsyetimit të këtij aktgjykimi, e që gjykata në tersi ja u ka falë besimin.

Pretendimet e mbrojtjes, se kinse dëshmitë Ev#9 dhe Ev#11 janë marrë në kundërshtim me ligjin, përkatësisht se nuk janë marrë sipas standardeve, Gjykata nuk i ka pranuar, për arsyet e dhëna në pikat 6.2 dhe 6.3 të arsyetimit të aktgjykimit.

Gjithashtu pretendimi i mbrojtjes, se nuk është provua që Laboratori i forenzikes dhe mjetet e punës, të kenë qenë të pa kalibruara , pastaj dyshimet se kemikalet e përdorura në ekspertim, a kanë qenë të testuara dhe me afat, si dhe licencimi i vetë ekspertëve, nuk qëndrojnë.

Kjo për faktin se në shqyrtim kryesorë ekspertët e Forenzikës , lidhur me këto pretendime, qartë dhe bindshëm kanë argumentua se Laboratori i forenzikes dhe mjetet e punës, kenë qenë të kalibruara , pastaj kemikalet e përdorura në ekspertim, kanë qenë të testuara dhe me afat, si dhe vetë ekspertët kanë qenë të licencuare, e që është arsyetua si në pikën 7 të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e ka pranua pretendimin e mbrojtjes, se nuk është provua që ka ekzistua grupi prej katër personave, e asë marrëveshja e grupit kriminal për kryerjen e veprës penale, e që sipas mbrojtjes, dyshimet për ekzistimin e fakteve, sipas parimit in dubio pro reo , duhet interpretuar ne favor te të pandehurit .

Në fakt , i dëmtuari G.G ishte i qarë dhe ai bindshëm ka provua se gjatë kohës sa mbahej nën kontroll, aty ishte së paku një person, i cili personave që i morën qelësat e këmbimores dhe shkuan atje, ju tha në telefon, duke u shpreh në shumës “a jeni gati”. Kjo i bie se nëse ishte vetëm një person, që e mbante në kontroll të dëmtuarin, kur ai në telefon tha në shumës “a jeni gati” do të thotë që ata atje në këmbimore ishin së paku edhe dy persona. Nga kjo gjendje e vërtetuar, është provua se në kryerjen e kësaj veprë penale, ishin mbi 3 persona .

Mirëpo pavarësisht se në kryerje e veprimeve sikur që u provua, ishin mbi tre persona , Prokurori i shtetit nuk ka arrit të siguroi dëshmi për ta provua se ka ekzistua grupi sikur që përcakton neni 120 par.12 të KPK-së, lidhjen e tyre apo marrëveshjen për kryerje të kohëpaskohshme të veprave penale. Mënyra e kryerjes së veprimeve të akuzuarit, së bashku me të paktën edhe tre persona tjerë tani të pa identifikuar , sikur që është provua , të qojnë në përfundimin se i akuzuari ka veprua në bashkë kryerje sikur që përcaktohet me neni 31 të KPK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon, se nuk është provua që pikërisht i akuzuari S. ja ka pre jaknen të dëmtuarit. Është fakt se dëshmitari- viktimja tha se derisa ai ishte i shtrirë , nuk pati mundësi ta vërej se cili prej tyre ja preu jaknen , e ai tha ”njeri nga ata, me thik apo diçka tjetër ma ka pre jaknen” . Pra ai nuk e diti se cili prej tyre i kreu ato veprime.

Në fakt, nga kjo dëshmi, nuk mund të nxirret përfundimi që pikërisht i akuzuari S. ja preu jaknen të dëmtuarit. Por nga dëshmia EV#9 (jakna e shqyer-e prerë) me ekspertizë shkencore është provua se në te ka pas njolla gjaku, e që gjaku në jakne ishte i të akuzuarit S.. Gjykata vlerëson se është fakt i vërtetuar që jakna i ishte pre viktimës, e meqë është provua se i akuzuari S. ka pasë kontakt me viktimën, me që në jaknen e viktimës, ka mbetë profili i ADN-së së të akuzuarit, vërtetimi i faktit se cili prej personave ja ka pre jaknen, nuk ka ndonjë peshë të madhe.

Gjithashtu, fakti i vërtetuar nga i dëmtuari, se njeri nga personat që e mbanin në kontroll të lidhur, pasi që foli në telefon me personat tjerë dhe tha “a jeni gati”, ata ja hoqën prangat nga duar, ja lidhen duart me një e lidhëse plastike , ngjyrë e bardhë, e nga ekspertiza shkencore është provua se në dëshminë Ev#11 ( një pjesë që është marrë në shtëpinë e viktimës) ka indikacione te profilit te S. B (#ADN6). Në fakt, pasi që viktimës ju hoqën prangat dhe ju lidhën duart me lidhëse , e aty mbeten gjurmët - përkatësisht profili i ADN-së së të akuzuarit S., me besueshmërinë shumë të madhe vërtetohet se kontaktin e fundit me viktimën e pati i akuzuari S..

Në këtë kontekst është vlerësua dëshmia CD incizimi i kamerës së sigurisë që është marrë në këmbimoren “te gazi”. Në këtë incizim vërehet qartë, kur një person i maskuar, hynë në këmbimore me dt. 27.12.2017 pikërisht në ora 0.42 min. e 15 sek. E bazuar në faktin e vërtetuar nga dëshmia EV.# 11 ( një pjesë e lidhëse plastike , ngjyrë e bardhë, që është marrë në shtëpinë e viktimës) që ka indikacione te profilit te S. B (#ADN6), e sikur që u tha më lartë se kontaktin e fundit me viktimën e pati i akuzuari S., atëherë me besueshmëri të fortë mund të nxirret konkluzioni se i akuzuari S., nuk ishte fare në këmbimore, por që aty ishte apo ishin, personat tjerë ende të pa zbuluar, të cilët pasi që i morën qelsat nga viktimë, ai apo ata, shkuan në këmbimore dhe i kryen veprimet –i morën të hollat dhe sendet tjera të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit.

Mbrojtësi pretendon, se nga dëshmitë listingu i telefonit të të akuzuarit nuk ka mund të provohet që i akuzuari ka komunikua me telefon në kohën kur pretendohet se ai ishte në shtëpinë e viktimës. Gjykata vlerëson se është fakt se nga dëshmia-listingu i telefonit të të akuzuarit nuk është provua që ai të ketë pas komunikime në atë kohë, por kjo nuk është bazë për të nxjerrë përfundimin se ai nuk ishte aty natën kritike, për faktin se i akuzuari ka mundë , përkatësisht me sigurinë më të madhe ai nuk e ka pas telefonin e tijë në përdorin në shtëpinë e viktimës.

Është vlerësua qëndrimin e mbrojtjes , pretendimi se nuk është provua me saktësi të plotë shuma e të hollave dhe vlera e saktë e sendeve të grabitura.

Në këtë rrethanë , sikur që u arsyetua në pikën 7.1 të arsytimit, Gjykata ja ka falë besimin të dëmtuarit që ai ti ketë pas shumat e përafërta të të hollave dhe të sendeve të deklaruara gojarisht dhe të konstatuara në një fletë në dorëshkrimin e tijë, e që ato të i janë marrë natën kritike në këmbimoren e tijë. Gjykata shumat e të hollave dhe sendet e grabitura natën kritike, i konsideron të vërtetuara si të përafërta me ato të deklaruara, e me sigurinë më të madhe , që tejkalojnë shumën prej mbi 5.000,00 ero, e që kjo shumë është element bazë kualifikuese të veprës penale të grabitjes sikur që përcakton neni 329 par. 2 të KPK-së

#### **10.Faktet e vërtetuara :**

Pas administrimit të provave , vlerësimit te tyre një nga një e ne lidhmëni reciproke me provat tjera , ne kuptim te nenit 361 te KPPK-se, Gjykata përtej çdo dyshimi ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga gjendja e fakteve te vërtetuara ne këtë mënyrë , e të arsyetuara si në pikat: 5 deri 9, të arsytimit të këtij aktgjykimi, gjykata përtej çdo dyshim vërtetohet se: I akuzuari, me dt.26.12.2017, rrethë orës 23, ne Rr. “ ..., ne Pejë, me përdorim te forcës apo kanosjes serioze për te sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, me qëllim qe ti sjelle vetes dhe personit tjetër dobi pasurore te kundërligjshme , se bashku me tre persona tjerë ende te pa identifikuar, kanë përvetësuar pasurin e luajtshme personit tjetër, ne atë mënyrë qe pasi që kanë shkua ne shtëpinë e te dëmtuarit G. G , e për mes qatisë kanë depërtua ne brendësi te shtëpisë, e kanë ndalë rrymën ne shtëpi, ne momentin kur i dëmtuari G. ka ardhë nga qyteti në shtëpinë e tij, e ka hap derën e shtëpisë dhe ka hyrë ne korridor , dy prej tyre i janë hedhur sipërmi duke thënë me fjalët “ Policia , policia” e shtrijnë për dysheme , me shirit ngjitës ja lidhin gojën dhe këmbët , e tërheqin zvarë deri ne dhomën e pritjes, ja vejnë prangat ne duar pas shpine, e ne kërkim te qelësave te këmbësorës “ T...” , pronë e te dëmtuarit qe gjendet ne qendër te qytetit për ballë pompës se Derivateve “ P...” , e godasin me mjete te forta ne kokë dhe shpind, për te detyruar te tregoj se ku i kishte fshehur qelësat e këmbësorës , me qërastë i shkaktojnë lëndime trupore, njeri prej te pandehurve me skalper ja prenë gjaketën te cilën e kishte te veshur i dëmtuari , ne gjepin e saj te brendshëm i gjejnë qelsat , te cilët i merrë njeri prej tyre dhe se paku dy prej tyre, pas mesnate

rrethë orës 0:42,15 të dt.27.12.2016 shkojnë ne kembimoren ne fjalë, e hapin derën me qelës , kanë hyrë brenda , e kanë qelë kasafortën dhe nga aty i marrin rrethë: 146.490,00 franga Zviceranë , 27.433,00 dollar amerikan , 52.090,00 euro, 1.237,23 euro ne valuta te ndryshme Norvegjeze , Suedeze etje, 262.95,00 lekë, si dhe një sasi ari në vlerë prej rrethë 15.000,00 euro, e pastaj përmes telefonit e njoftojnë njërin prej të pandehurve , qe e kishte ne mbajtje te dëmtuarin ne shtëpinë e ti, e pastaj largohen ne drejtim te pa njohur .

Si rezultat i kësaj gjendje te vërtetuar faktike, gjykata për hire te ruajtjes se identitetit të akuzës, në kuptim të nenit 360 par.2 të KPPK-së ka bërë ndryshimin e datës , kohës , përshkrimit të figurës së veprës penale dhe kualifikimin juridik të veprës penale.

### **11. Vlerësimi juridik i çështjes :**

Për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet të ekzistoi qëllimi i fitimit të dobisë pasurore, por nuk është e domosdoshme që dobia të jetë realizua pjesërisht apo tërësisht, e që në rastin konkret është provua që dobia pasurore është realizua. Fakti që i akuzuari i kreu veprimet inkriminuese në bashkëveprim me persona tjerë deri tani të pa zbuluar e me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, është tregues se bëhet fjalë për egoizëm ekstrem dhe motiv i paskrubullt që me çdo kusht të fitohet dobia pasurore.

Bazuar në parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm ndaj kryesit ,nenit 3 të kodit penal tani të zbatueshëm, gjykata ka zbatua ligjin që ka qenë në fuqi në kohen e kryerjes së veprës penale si më të favorshëm për të akuzuarin.

Nga gjendja faktike e vërtetuar në këtë mënyrë , gjykata ka ardhë ne përfundim se ne veprimet që i kreu i akuzuari, ditën , kohen , vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale si bashkë kryes te grabitjes nga neni 329 par.2 lidhur me par.1 , e lidhur me nenin 31 te KPK-së.

Për këtë gjykata te akuzuarin gjen dhe e shpallë fajtorë e penalisht përgjegjës , nga se ne rastin konkret nuk ka gjet as një rrethanë e cila kishte për ta përjashtua nga përgjegjësia penale.

### **12. Vendimi mbi dënim:**

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të cilat kishin për të ndikua në llojin dhe lartësinë e dënimit te parapara me nenin 74 te KPK-së ,e te cilat gjykata i ka vërtetua gjatë shqyrtimit gjyqësorë .

Nga rrethanat rendues për te akuzuarin gjykata ka marrë, shkalla e lartë e pjesëmarrjes në veprën penale dhe mënyra posaçërisht mizor e veprimit, moshja relativisht e shtyrë e viktimës, shkalla e lartë e dëmtimit të vlerës së mbrojtur-fakti se i dëmtuar ka pësua lëndime trupore, shkalla e lartë e dëmit të shkaktuar, qëllimi i te akuzuarit për fshehjen e krimit , veprime këto te cilat paraqesin shkallë te lart te intensitetit te rrezikshmërisë shoqërore te veprës penale te kryer.

Ndërsa si rrethana lehtësuese janë marre , moshja e të akuzuarit relativisht e re, sjellja e tij para kryerjes së veprës penale, ai nuk ishte i dënuar për ndonjë vepër penale, e as që është duke u zbatua ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij.

Duke i pasur parasysh te gjitha këto rrethana, gjykata, te akuzuarin e ka gjykua me dënim burgimi dhe dënim gjobe si në dispozitiv te aktgjykimit.

Kështu është vendosur me bindje të thelle se ky dënim është në harmoni me intensitetin e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe të shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe se i njëjti dënim do të shërbejë si preventiv gjenerale e posaçërisht i asaj individuale, të forcimit të moralit të shoqërisë dhe disiplinës qytetare, e që është në pajtueshmëri me kërkesat e popullit, me bindje që edhe me këtë dënim, do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i parapare me nenin 41 par.1 pika 1 dhe 2 të KPK-së.

### **13. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës:**

Vendimi që i akuzuari të ja kompensojnë gjykatës shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet tjera në formë paushalli është i bazuar në nenin 99 par. 2 pika 2 dhe 6 të KPPK-së, dhe është gjykuar për shpenzimet për transport dhe shpenzimet tjera në formë paushalli, ndërsa që vendimi që i akuzuari të detyrohet që në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 50 ero, është i bazuar në nenin 39, par. 3, pikat 3.1 dhe 3.2, të Ligji për kompensimin e viktimave të krimit Nr. 05/L -036 dhe është gjykuar në lartësinë si në dispozitiv, me bindje se i akuzuari i ka kushtet për përmbarim.

### **14. Vendimi për dëmshpërblim:**

Vendimi që pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës për dëmshpërblim, të udhëzohet në kontest të rregullt civil, është i bazuar në nenin 463 par.1 e 2 të KPPK-së, nga se të dhënat e mbledhura në këtë procedurë, nuk paraqesin bazë të sigurtë për gjykim të plotë e as të pjesshëm të dëmit të shkaktuar.

Nga sa u tha me lartë, është vendosë si në dispozitivit të këtij aktgjykimit.

**U VENDOS NË GJYKATEN THEMELORE – Departamenti për Krime të Renda në Pejë, me dt. 10.10.2019  
DKR. P.nr. 103/2018**

**Sekretarja Juridike**  
Binake Mulliqi

**Kryetari i Trupit Gjykoës - Gjyqtari**  
Sylë Lokaj

Anëtarët e trupit gjykoës-Gjyqtarët  
1 Sami Sharragjiu d.v.  
2. Sejdi Blakaj d.v

### **UDHZIM JURIDIK**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes, Gjykatëse se Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate